



ANEKS MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

1. Komunës së Vushtrrisë - përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë;
dhe
2. OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" - përfaqësuar nga z. Isak Skenderi,
drejtor ekzekutiv.

QËLLIMI I ANEKS MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT:

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të lartpërmendura kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me datën 30.06.2020 në Vushtri për menaxhimin institucional të Qendrave Mësimore dhe me aneks marrëveshje e nënshkruar me 17.01.2022 me numër protokollit të komunës 56/22 që deri më tani janë menaxhuar nga OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve", bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.19/2018 mbi "Themelimin dhe Funkcionalizimin e Qendrave Mësimore nga MASHTI-të".

Duke u bazuar në kërkesën e Komunës së Vushtrrisë për aneks marrëveshje e cila mbështetet në nenin 6 të marrëveshjes baze Ndryshimi/plotësimi i marrëveshjes dhe shkëputja e saj, konkretisht në pikën 6.2., palët pajtohen që të lidhin plotësim i aneks marrëveshjes e nënshkruar me datën 17.01.2022 e cila do të detajojë bashkëpunimin e mëtejshëm midis dy palëve të lartpërmendura.

ME KËTË, PALËT U PAJTUAN SI NË VIJIM:

1. Komuna e Vushtrrisë bazuar në rolet dhe përgjegjësitë e Komunës në marrëveshjen e bashkëpunimit, rritë pjesëmarrjen e saj financiare për realizimin e Qendrës Mësimore në komunën e Vushtrrisë, dhe kështu siguron pagesën e qirasë së objektit të qendrës mësimore nga 120 € sa ka qenë në 150 € për muaj, pasi që objekti i cili është shfrytëzuar deri më tani me qira nuk plotëson kushtet elementare për zhvillimin e mësimin dhe kështu do të zhvendoset në objektin tjetër po ashtu me qira.
2. Komuna e Vushtrrisë do të rritë pjesëmarrjen e saj financiare për pagesën e qirasë për 6 muaj në vitin 2022, duke filluar nga korriku 2022. Komuna e Vushtrrisë do të rrisë participimin e pagesës së qirasë në mënyrë direkte në shumën e përgjithshme 180 €.
3. Paratë janë të destinuara vetëm për pagesën e qirasë së objektit të qendrës mësimore në fshatin Prelluzh të Vushtrrisë.

4. Të gjitha kushtet tjera të marrëveshjes bazë dhe aneks marrëveshjes e nënshkruar me datën 17.01.20222 mbesin të njëjta;

Kjo aneks marrëveshje është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për komunën dhe një për organizatën. Vlefshmëria e saj është për periudhën deri më: 31.12.2022.

Palët nënshkruese:

Komuna e Vushtrrisë:

OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve":

Kryetari i Komunës në Vushtri,

Drejtori ekzekutiv, Isak Skenderi

Ferit Idrizi



r.m.



Data ____ / ____ / ____